



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Besim Ilazi, Kryetar i Komunës së Kaçanikut Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erbilin Hetemi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 14.01.2025 VI-020-4
Zyrtaret përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	
	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Vjosa Ahmetaj, Zyrtare e Lartë për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren Nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim 01 Nr. 060/01-31287/24 për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025

I miratuar më datë: 24.12.2024

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.01.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Kaçanikut në mbledhjen e mbajtur me datë 24.12.2024, ka miratuar Vendimin 01 Nr. 060/01-31287/24 për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025.

MAPL, konstaton së vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Kaçanikut, është bazuar në nenin 13 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019), nenin 6 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 6 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Kaçanikut, për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2025, e cila është nxjerrë nga lista e përgjithshme e pronave komunale.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut me datë 24.1.2024, është miratuar më 18 vota për, 7 kundër dhe 2 abstenim.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejme lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Za :	Besim Ilazi , gradonačelnik opštine Kačanik Kemal Murseli , predsedavajući Skupštine opštine Kačanik	
Kopija:	Jedinici za administraciju dokumenata u MALS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi , ministar MALS-a, Jeton Qela , generalni sekretar MALS-a,	
Od:	Erbilin Hetemi , rukovodioc Pravnog odeljenja/MALS	Datuma, 14.01.2025 VI-020-4
Odgovorni službenici:		
1.Službenik za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa , rukovodilac odseka za monitorisanje opština	
2.Službenik za izradu pravne procene	Vjosa Ahmetaj , viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Kačanik	
Vrsta odluke:	Odluka Skupštine opštine Kačanik	

Poštovani/a gradonačelniče,
Poštovani/a predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 10/2019 o administrativnom razmatranju opštinskih akata, kao i Uredbom br. 06/2021 o dopuni - izmeni Uredbe (VRK) br.10/2019, o administrativnom razmatranju opštinskih akata, a na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva definisanih osnovnim zakonima i Uredbom Vlade br. 14/2023, o administrativnim oblastima i nadležnostima Kancelarije premijera i ministarstava, Pravno odeljenje i monitorisanje opština MALS-a, primilo je na obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka 01 br. 060/01-31287/24 o odobravanju posebnog spiska opštinske imovine koja se planira dati na korišćenje u 2025. godini

Usvojena dana, 24.12.2024.godine,

Predložena na razmatranje u MALS-u dana: 03.01.2025

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.

Obrazloženje

Skupština opštine Kačanik je na sednici održanoj 24.12.2024. godine, odobrila Odluku 01 br. 060/01-31287/24 o odobravanju posebnog spiska opštinske imovine koja se planira dati na korišćenje u 2025. godini.

MALS konstatuje da je odluka koju je donela Skupština opštine Kačanik zasnovana na članu 13 stav 1 i 2 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine (Službeni list Republike Kosovo br. 10/03 april 2019), član 6 stav 1 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura davanja na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine, i člana 6 slovo (h) Statuta opštine Kačanik, o odobravanju posebne liste opštinske imovine koja se planira dati na korišćenje u 2025. godini, koji je izuzeta sa opšte liste opštinske imovine.

Odluka je odobrena je na sednici Skupštine opštine Kačanik dana, 24.01.2024. godine, sa 18 glasova za, 7 protiv i 2 uzdržana glasa.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za bilo kakva dalja pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.